



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK. Nr. 265/2020
Datë: 07 dhjetor 2020

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.1, 1.12, 1.17 dhe 1.25 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e 243-të, të mbajtur me datë 07 dhjetor 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet plani i Projektit të Sistemit të Menaxhimit Informativ të Lëndëve (SMIL) për largimin e regjistrave manual nga përdorimi në gjykata.
- II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, përmes Projektit SMIL-it është duke synuar digjitalizimin e procesit të punës në gjykata. Nëkuadër të këtij procesi, është edhe largimi gradual i punës manule në gjykata duke synuar procedimin e lëndëve vetën në formë elektronike pa përdorimin e letrës. Kjo do të realizohet në faza, ashtu si krijohen kushtet teknike. Në këtë drejtin, hapi i parë është largimi i regjistrave manual në gjykatë.

Pjesë e planit për largimin e regjistrave manual nga përdorimi ka qenë pilotimi i largimit nga përdorimi i një regjistri. Për këtë qëllim, Projekti i SMIL SMIL ka pilotuar largimin e regjistrave të manual të pranimit. Pilotimi është bërë në periudhën 22 Qershor 2020 deri më 14 Shtator 2020 në Gjykatën Themelore në Ferizaj, që është gjykatë pilote në projekt. Pilotimi i largimit të regjistrave manual nga përdorimi ka rezultuar i sukseshshëm dhe me këtë rast, Projektii SMIL-it ka përgatitur edhe planin për zgjerim të largimit në të gjitha gjykatat, për çka edhe Këshilli ka miratuar këtë plan, me qëllim të rritjes së efikasitetit në sistemin gjyqësor.

Skender COCAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- TIK/SMIL,
- Gjykatave Themelore të Republikës së Kosovës,
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.